



Medica-Gjakova
Medica Gjakova

Nr. Protokol. 13 Nr. fq. 05
Data. 22.05.2019
G J A K O V Ë

OIK
Oda e Infermierëve të Kosovës
Kosovo Chamber of Nurses and other health professionals of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA E KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA E KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO

Oda e infermierëve mëtarë dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komara med. infermier. bashkëpunimi i stajillë zdravstvenih stručnjaka Kosova
Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo

ARCHIV ARCHIV ARCHIVE

Nr. Prot.	476	Nr. i faq.	- 5 -	Data:	
Broj. prot.		Br. str.		Datum:	
Prot. no		No. page.		Date:	22.05.2019

SHKURTIMET: SHKURTIMET: SHKURTIMET

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet:

SHOQATA E GRAVE "MEDICA GJAKOVA"

përfaqësuar nga znj. Mirlinda Sada

dhe

ODËS SË INFERMIERËVE TË KOSOVËS (OIK)

përfaqësuar nga z. Naser Rrustemaj

Lënda:

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi (MB) lidhet në mes të Shoqatës së grave "Medica Gjakova" që udhëhiqet nga znj. Mirlinda Sada - Drejtoreshë Ekzekutive, dhe Odës së Infermierëve të Kosovës. (OIK).

Shoqata e grave "Medica Gjakova" ka si mision përmirësimin e gjendjes mendore dhe fizike të grave të mbijetuara nga dhuna si dhe ndikimin mbi politikat sociale në mbështetjen e mirëqenies së grave dhe integrimin e tyre në të gjitha fushat jetësore. Vizioni i shoqatës: Gratë dhe vajzat në Kosovë, jetojnë në shoqëri pa dhunë, të respektuara dhe me dinjitet.

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i përgjithshëm i marrëveshjes është implementimi i projektit “Përmirësimi i shërbimeve dhe kujdesit shëndetësor ndaj traumave për gra dhe vajza të mbijetuara të dhunës në baza gjinore dhe të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë”.

Në përgjithësi projekti synon forcimin e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve shëndetësore publike për gra dhe vajza të mbijetuara të dhunës në baza gjinore dhe të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, dhe implementohet në dy komuna në atë të Gjakovës dhe Prizrenit.

Rreth 15 Qendra të Mjekësisë Familjare në Gjakovë dhe Prizren dhe Spitalet e përgjithshme të Gjakovës dhe Prizrenit janë të përfshirë drejtpërdrejt në këtë projekt. Ministria e Shëndetësisë (MSH) dhe Drejtoratet Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Gjakovë dhe Prizren janë gjithashtu të përfshirë në projekt.

Projekti bazohet në tri komponenta/objektiva:

Komponenta 1 (Kualifikimi i profesionistëve të kujdesit shëndetësor)-

forcon kapacitetin e profesionistëve shëndetësor për të ofruar shërbime shëndetësore për grupin e ndjeshëm të grave dhe vajzave të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës (duke përfshirë identifikimin e simptomave, referimin dhe trajtimin apo këshillimin).

Komponenta 2 (Institucionalizimi i shërbimeve shëndetësore për menaxhimin e stresit dhe traumës)

forcon kapacitetet institucionale duke ngritur ndërgjegjësimin dhe përgjegjësinë e strukturave menaxheriale dhe vendimmarrësve në institucionet shëndetësore pjesëmarrëse në projekt për grupin e prekur të grave dhe vajzave

Komponenti 3 (Rrjetëzimi ndërkombëtar dhe avokimi)

forcon kapacitetet e pikave të kontaktit të institucioneve shëndetësore dhe bartësve lokal të projektit duke mundësuar shkëmbimin e praktikave më të mira dhe njohjen me proceset e avokimit ndërkombëtar.

Për të realizuar qëllimin dhe objektivat e projektit, shoqata e grave “Medica Gjakova” do të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me SHSKUK, Odën e Mjekëve, Odën e Infermierëve dhe Drejtoratet Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Prizren dhe Gjakovë.

Neni 2
Obligimet e Odës së Infermierëve të Kosovës
(OIK)

1. Ta përkrahë Shoqatën e grave “**Medica Gjakova**” në zhvillimin dhe implemetimin e projektit “Përmirësimi i shërbimeve dhe kujdesit shëndetësor ndaj traumave për gra dhe vajza të mbijetuara të dhunes në baza gjinore dhe të dhunës seksuale gjate luftës në Kosovë;
2. Përzgjedhja e profesionistëve shëndetësorë (mjekë të përgjithshëm, gjinekologë, infermierë, psikologë, mami) do bëhet në bashkëpunim me Medica Gjakova, ndërsa infermierët do të jenë të përzgjedhur nga rradhët e Kuvendit të Odës së Infermierëve (sipas rekomandimeve të OIK-ut).
3. Pjesëmarrja e profesionistëve shëndetësor në trajnime për t’u trajnuar si trajnerë ose” pika referuese” dhe angazhimi i tyre për trajtimin e stresit dhe traumës në grupin e prekur të grave dhe vajzave në institucionet publike shëndetësore. (Komponenta 1);
4. Përfshirja e institucioneve shëndetësore në menaxhimin e projektit, në lobim dhe avokimi në nivel kombëtar (Komponenta 2);
5. Shqyrtimi i përvojave dhe i rezultateve të projektit lidhur me përmirësimin e qasjes në kujdesin shëndetësor në grupin e grave dhe vajzave të prekura.;
6. Fasilitimi i akreditimit të profesionistëve shëndetësor të trajnuar për ofrimin e shërbimeve për grupin e grave dhe vajzave të prekura për menaxhim të stresit dhe traumës;
7. Sigurimi i gatishmërisë së kapaciteteve të institucioneve shëndetësore publike për promovimin e programit.

Neni 3
Obligimet e “Shoqata e grave- Medica Gjakova”

1. Përgjegjëse për menaxhimin/kontrollin e përgjithshëm të projektit, punën e avokimit dhe koordinimin me akterë të tjerë institucional pjesëmarrës në projekt;
2. Koordinon zbatimin e projektit të përgjithshëm sipas Kornizës Logjike dhe dokumenteve tjera të planifikimit;

3. Harton Plan veprimin specifik për përfshirjen e insitucioneve shëndetësore vendore publike në projekt;
4. Në bashkëpunim me insitucionet shëndetësore vendore publike, merrë pjesë në zhvillimin dhe përshtatjen e manualit të trajnimit me përfshirjen e profesionistëve vendor dhe ndërkombëtar , për t'i ndihmuar trajnerët lokalë në përgatitjen dhe mbajtjen e kurseve të trajnimit;
5. Mbështet konceptin e Trajnimi i Trajnerëve dhe zhvillon/organizon trajnimin si bashkë-trajner përmes profesionistëve të akredituar . Shoqëron trajnerët e trajnuar gjatë trajnimit të profesionistëve shëndetësor. Si dhe si pjesë e punës së avokimit zhvillon ngjarje për sensibilizim profesional;
6. Organizon dhe monitoron në bashkëpunim me institucionet shëndetësore relevante trajnimet për trajnerë profesionist (8 + 8) në Gjakovë dhe Prizren, të cilët më pas do t'i trajnojnë edhe 50 të tjerë personel shëndetësor (50+50);
7. Përpilimi i udhëzuesit/fletushkave në bashkëpunim me institucionet shëndetësore relevante rreth projektit për qasjen në shërbime shëndetësore të ndërlidhura me menaxhimin e stresit dhe traumës për grupin e grave dhe vajzave të prekura;
8. Në bashkëpunim me insitucionet shëndetësore relevante, organizon ngjarje publike dhe përmes materialeve plotësuese (udhëzuesve/fletushkave) informon opinionin rreth projektit

Neni 4 Realizimi i projektit

Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme nga muaji Maj 2019 deri në muajin Maj 2020 me mundësi vazhdimi të projektit edhe për dy vite tjera, deri në vitin 2021. Ripërtirja e Marrëveshjes do të bëhet për (3) tre vite rradhazi- për secilin vit në kuadër të (3) tre vjeçarit të parë të Projektit. (Ripërtirja do të bazohet në rregullat e Odës së Infermerëve të Kosovës - OIK-ut). Marrëveshja mund të ndryshohet /amandamentohet me pëlqimin e ndërsjellët të palëve. Të dy palët kanë të drejtë që të rinegociojnë marrëveshjen duke u bazuar në të drejtën e tyre të përcaktuar. Çdo modifikim i kësaj marrëveshje duhet bërë me nënshkrim të të dy palëve.

Neni 5
Kushtet e përgjithshme

Kjo Marrëveshje bashkëpunimit përmban 5 faqe dhe është përpiluar në 4 ekzemplarë të njëjtë, prej të cilëve nga 2 ekzemplarë i marrin palët kontraktuese.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi paraqet vullnetin e lirë të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëjtin do ta zbatojnë me përpikëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të këtij Memorandumi. Kontrata hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

PALËT

Shoqata e Grave "Medica Gjakova


"Oda e Infermierëve të Kosovës"
(OIK)

Znj. Mirlinda Sada

Dr. Naser Rrustemaj

(Drejtoreshë ekzekutive)

(Kryetar i OIK-së)



Data: 22 .05. 2019

Data: 22.05.2019